



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1800/1
Datë: 04.11.2024

SHPALLJE KONKURSI

Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së shtatë për nivelin e V-të, të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” në: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Gjakovë dhe Mitrovicë për vitin shkollor 2024/2025

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve

Për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, për vitin shkollor 2024/2025, mund të aplikojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë dhe janë më të vjetër se 18 vjeç.

Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të aplikojnë për regjistrim.

Të drejtë aplikimi kanë:

- 1.1 Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).

2. Ofrimi i kualifikimit

Në këtë vit shkollor, kualifikimi do të ofrohet në 8 grupe, prej tyre 3 grupe në Prishtinë dhe nga një grup në Ferizaj, Gjilan, Prizren, Gjakovë dhe Mitrovicë. Baza e ofrimit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Ferizaj si Institucion i akredituar nga Institucioni prestigjioz Britanik **PEARSON**.

3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me diplomë sipas standardeve të **BTEC**.

4. Kreditë

Kualifikimi për “*Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore*” zgjat një vit shkollor dhe vlerësohet me 1200 orë (60 kredi) të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional.

5. Pagesa për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit realizohet sëbashku me institucioni prestigjioz britanik PEARSON. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 15 ditëve pasi të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej **350 (treqind e pesëdhjetë) Euro**.

6. Aplikimi

Aplikimi për regjistrim në kualifikimin e nivelit V-të, “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” bëhet përmes platformës zyrtare “eKosova” <https://ekosova.rks-gov.net/565>

Përveç të dhënave të cilat kërkohen nga sistemi, çertifikatën e vendbanimit, ju jeni të obliguar të ngarkoni edhe Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë diplomuar pas vitit shkollor 2015/2016, apo çertifikatën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollimin e mesëm të lartë para vitit shkollor 2014/2015.

Kërkesa minimale është diploma e shkollimit të mesëm të lartë, dhe në rast se jeni i/e diplomuar në ndonjë nivel më të lartë të kualifikimit (bachelor apo master), ju mund të aplikoni me diplomën e fundit.

7. Afati për aplikimi

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 05 deri 14 nëntor 2024.

Kandidatët do të njoftohen me email për kohën dhe vendin e testimit. Testimi do të realizohet përmes Platformës Online të Testimit.

Rezultatet e testit të kandidatëve dergohen me email të kandidatët përmes platformës “eKosova”.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në AAAPARr përmes platformës “eKosova”.

8. Kriteret e regjistrimit

Kandidatët që vlerësohen në bazë të rezultateve të testit, do të pranohen sipas radhitjes të pikëve maksimale për secilën komunë.

9. Kuotat për pranim të kandidatëve sipas komunave

Do të pranohen gjithsejt 200 kandidatë për të gjitha komunat sipas kuotave dhe komunave si në tabelën në vijim.

Nr	Komuna	Kuota	Nr	Komuna	Kuota	Nr	Komuna	Kuota
1	Prishtinë	15	11	Pejë	9	21	Suharekë	5
2	Podujevë	10	12	Istog	7	22	Malishevë	6
3	Fushë Kosovë	8	13	Klinë	7	23	Ferizaj	7
4	Obiliq	6	14	Deçan	4	24	Lipjan	8
5	Novo Bërdë	2	15	Gjilan	10	25	Shtime	7
6	Vushtrri	10	16	Gjakovë	9	26	Kaçanik	5
7	Mitrovicë	8	17	Rahovec	4	27	Hani i Elezit	4
8	Skenderaj	7	18	Prizren	13	28	Viti	7
9	Drenas	7	19	Dragash	3	29	Junik	3
10	Kamenicë	6	20	Mamushë	1	30	Shtërpçë	2

Në Prishtinë do të organizohen 3 grupe me studentë të pranuar nga këto komuna:
Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Istog, Klinë, Malishevë, Lipjan.

Në Prizren 1 grup me studentë të pranuar nga këto komuna:
Prizren, Suharekë, Rahovec, Dragash, Mamushë.

Në Gjakovë 1 grup me studentë të pranuar nga këto komuna:
Gjakovë, Pejë, Deçan, Junik.

Në Mitrovicë 1 grup me studentë të pranuar nga këto komuna:
Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri.

Në Gjilan 1 grup me studentë të pranuar nga këto komuna:
Gjilan, Kamenicë, Novo Bërdë, Viti.

Në Ferizaj 1 grup me studentë të pranuar nga këto komuna:
Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtërpçë.

10. Fillimi i vitit shkollor

Viti shkollor do të fillojë në dhjetor 2024.